

# KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR



## INFORMACIONE

### PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUAJIT JANAR

Taekwondo - KOKSH vijon mbështetjen ndaj Federatave Shqiptare Sportive

Presidenti i KOKSH merr pjese në përrurimin e palestrës kombëtare të mundjes

Akademia Olimpikë Shqiptare - Sesioni Vjetor 2004

Start 2005- KOKSH-UNDP Takim Pune

KOKSH dhe Ambasada Franceze në projekte të përbashkëta

COE - Përgatitjet për Seminarin Europian në Tiranë

Rinovimi i Protokoll Marrëveshjes së Bashkëpunimit me AEFS « Vojo Kushi »

Lojrat Mesdhetare « Almeria 2005 » - Bursa për Sportistë të sportive individuale

“Identifikimi dhe zhvillimi i talenteve të Reja”

MEMOS VIII-KOKSH investon në kualifikimin e stafit

MONTHEY 2005 - Festivali Dimëror Olimpik i Rinisë Europiane



Akademia Olimpikë Shqiptare  
*Sesioni Vjetor 2004*



KOKSH-AEFS  
Rinovimi i Protokoll Marrëveshjes së  
Bashkëpunimit

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Rruga: “Muhamet Gjollësja” - Tel. +355 235249/240602 - Fax. +355 240565

E-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) - [www.nocalbania.org.al](http://www.nocalbania.org.al)



## Taekwondo - KOKSH vijon mbështetjen ndaj Federatave Shqiptare Sportive

Me mbështetjen e KOKSH, Federata Shqiptare e Taekwondos ka organizuar në muajin Dhjetor 2004 një seminar trainues për trainerë dhe arbitra. Federata Shqiptare e Taekwondos ka ftuar në Tiranë specialistin Kroat z. Miroslav Brezhan mjaft i njohur në Europë në fushën e arbitrimin të sportit të Taekwondos, i cili për 4 ditë ka organizuar seminare teorike dhe praktike. Ky projekt kishte për qëllim kualifikimin dhe informimin e arbitrave Shqiptarë të Taekwondos për një sport më cilësor më të sigurtë dhe më afër parametrave ndërkombëtarë në fushën e gjykitimit

### 11.01- Presidenti i KOKSH merr pjesë në përrurimin e palestrës kombëtare të mundjes.

Me rastin e përrurimit të Palestrës së Ekipit Kombëtar të Mundjes, Presidenti i KOKSH z. Hysen Domi ka marrë pjesë ceremoninë e inaugurimit të këtij ambjenti. Në fjalën përshëndetëse të tij, theksoi se "krijimi i të tilla ambjenteve do të shërbejnë në rritjen cilësore të sportistëve tanë dhe rrjedhimisht edhe të rezultateve të tyre". Gjithashtu Presidenti i KOKSH z. Domi gjeti rastin të falenderojë edhe Ministrinë e Kulturës Rinisë e Sporteve e cila mundësoi financimin për ngritjen e këtij ambjenti bashkëkohor dhe kontributin e saj në sportin elitat.

### 14.01.-Akademia Olimpikë Shqiptare-Sesioni Vjetor 2004

Në ambjentet e AEFS « Vojo Kushi », Akademia Olimpikë Shqiptare zhvilloi sesionin vjetor shkencor të saj për vitin 2004. Theksi i temave në këtë sesion shkencor iu kushtua Lojra Olimpikë « Athina 2004 » dhe Shqipëria në Historinë e Lojra Olimpikë. Temat që u referuan në këtë sesion ishin :

#### « Shqipëria në Lojrat Olimpikë »

*Prof.As.Dr. Bardhyl Misja*

*Dr. Arben Kaçurri*

#### « Rruga për në Athina 2004 »

*Stavri Bello*

*Sekretar i Përgjithshëm i KOKSH*

#### « Vizione nga Kongresi i 10-të Botëror i Sportit për të Gjithë »

*Prof.Dr. Ilija Gasbo*

Pjesmarrës në sesion ishin Pedagogë dhe Studentë të AEFS, përfaqësues nga qendra kërkimore shkencore, federatat sportive,etj.



### 14.01 Start 2005- KOKSH-UNDP Takim Pune

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello dhe Përgjegjësjë e Mardhënëve me Publikun, Marketing dhe Media e KOKSH zj. Elda Gjoka kanë zhvilluar një takim pune në zyrat e UNDP në Tiranë me përfaqësuesen e Zyrës së Koordinimit të Agjensive të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, znj. Eldisa Lloshi. Në takim u bisedua për hartimin e kalendarit për vitin 2005 të projekteve të përbashkëta midis KOKSH dhe UNDP në kuadër të rrjetit të bashkëpunimit tashmë të vendosur dhe që ka filluar ti japë frutet e saja të bashkëpunimit. Viti 2005 është përcaktuar nga Kombet e Bashkuara si viti i Edukimit dhe Zhvillimit nëpërmjet Sportit, dhe në këtë kuadër, iniciativave të përbashkëta do t'i shërbejnë përmbushjes së objektivave respektive.

### 14.01 KOKSH dhe Ambasada Franceze në projekte të përbashkëta

Përfaqësuesi i Ambasadës Franceze znj. Catherine Choussianov, përgjegjëse e kulturës dhe sportit, zhvilloi në KOKSH një takim pune me Sekretarin e Përgjithshëm të KOKSH. Qëllimi i këtij takimi konsistonte në krijimin e mundësisë së organizimit të një seminari, në kuadër të rritjes së efikasitetit të administratës sportive në Shqipëri, në veçanti të asaj fiskale.

### 19.01 COE – Seminari European në Tiranë

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello, ka zhvilluar një takim pune me Drejtoreshën e Marketingut të Hotel "Sheraton" znj. Bujana Xhaxhiu për përgatitjet mbi zhvillimin në Shqipëri të Seminarit të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të COE (Komitetëve Olimpikë Europianë).

### 27.01 Rinovimi i Protokoll Marrëveshjes së Bashkëpunimit me AEFS « Vojo Kushi »

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional midis Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve « Vojo Kushi », të bindur për përgjegjësitë institucionale dhe një koordinimi më frytdhënës të veprimtarive të tyre në zhvillimin e lëvizjes Olimpikë, Edukimit Fizik dhe Sportit në Shqipëri në përmasat dhe nivelet që shtron koha, të dy institucionet kanë prezantuar arritjet e bashkëpunimit të tyre bazuar në Protokoll Marrëveshjen e Bashkëpunimit për periudhën 2003-2004. Të kënaqur për bashkëpunimin frytdhënës KOKSH dhe AEFS « Vojo Kushi » vendosën të vazhdojnë këtë bashkëpunim.



Në marrëveshje janë shtuar edhe pika të reja në mënyrë që hapësirat për bashkëpunim të jenë më të mëdha. Rinënskrimi i Protokollit të Bashkëpunimit tashmë të rinovuar u firmos nga autoritetet më të larta të institucioneve : Presidenti i KOKSH z. Hysen Domi dhe Rektori i AEFS z. Sejfulla Shtëpani. Të pranishëm në ceremoni ishin anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të KOKSH, Pedagogë dhe studentë të AEFSs, përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues të institucioneve sportive si QKSHS, Federatat Sportive etj.

### Lojrat Mesdhetare « Almeria 2005 » - Bursa për Sportistë të sporteve individuale.

Në kuadër të organizimit dhe përgatitjeve të Lojrave Mesdhetare « Almeria 2005 », KOKSH ka përfituar 3 bursa trainimi për sportistë nga Programi i ICMG. Këto bursa trainimi që konsistojnë në një trainim stërvitor deri në 1 muaj të sportistëve në një nga kampet stërvitore të vëndeve të pellgut të Mesdheut, i japin mundësi sportistëve të rrisin kapacitetet e tyre sportive dhe njëkohësisht të njihen me nivelin e sportistëve të tjerë. Nga një vlerësim i rezultateve të marra kohët e fundit, këto bursa të i kanë përfituar FSHM, FSHGJ dhe FSHB. Sportistët që do të përfitojnë këtë bursë janë :

Mundje – **Sahit Prizreni**  
Gjymnastikë – **Ornela Çuko**  
Boks – **Jozef Sermi**

### “Identifikimi & Zhvillimi i Talenteve të Reja”

Projekti - faza 2004 - Administrata e KOKSH ka përmbyllur fazën 2004 të veprimeve financiare me përfituesit e projektit të vitit 2004. Tashmë ky hap shënon edhe konkludimin e Projektit për ciklin 2001-2004, ndërkohë që të tjera projekte do të priten të zbatohen në të ardhmen nën patronazhin e Solidaritetit Olimpik për Ciklin 2005-2008.

### 23-30.01 MEMOS VIII Koordinatorja e

marrëdhënieve me Median & Publikun e KOKSH Elda Gjoka, vijon Masterin Ekzekutiv për Administrimin e Organizatave Sportive, në Modulën e dytë të tij, i cili u zhvillua në Kuala Lumpur, Malajzi. Ky modul subjekt të tijin pati pikërisht “Marketingun Sportiv”. Duke synuar kështu që KOKSH të realizojë një strukturë profesionale marketing, e cila në të ardhmen t’i shërbejë edhe federatave anëtare të KOKSH, me eksperiencën e tij.

22-30.01 “FOJE” Monthey 2005 – *Festivali Dimëror Olimpik i Rinisë Europiane* u zhvillua në Zvicër, dhe këtu ekipi Olimpik Rinor Shqiptar u përfaqësua me dy skiatorë: Skënder Molla nga qyteti Tiranës dhe Stavri Burda nga qyteti Korçës. Dy skiatorët nën drejtimin e trenerit të tyre z. Shkëlqim Mema njëkohësisht edhe President i Federatës së Skive konkuruan në garën “Ski Alpine”.